



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KOMUNA E DRAGASHIT
OPŠTINA DRAGAŠ
DRAGASH MUNICIPALITY

Raporti Vjetor Financiar

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022

Protokolli dalës i Organizatës Buxhetore

Protokolli hyrës i Thesarit të Kosovës

Neni 12

DEKLARATË E PASQYRAVE FINANCIARE

Për: **NYSRET KOCA, Zëvendësues i Drejtorit të Përgjithshëm i Thesarit**

Nga: **BEXHET XHELADINI Zyrtar Kryesor Administrativ (ZKA)**

BURIM ALIU Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF)

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”, i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kjo deklaratë jipet në lidhje me prezantimin e Pasqyrave Financiare të organizatës buxhetore për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022 dhe është pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Ne besojmë dhe konfirmojmë, që:

- Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqësin apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
- Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me burimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës janë të plota dhe të sakta.
- Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta.
- Nuk ka tjera llogari bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2022.
- Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullatore të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare.
- Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare
- Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur në mënyrën e duhur.
- Të gjitha huatë e pranuar janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas legjislacionit në fuqi
- Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës, i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare që janë të bashkangjitura paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të paanëshëm të financave dhe transaksioneve financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022 të institucionit të komunës së Dragashit.

Data: 27 / 01 / 2023

Datë: 27 / 01 / 2023

(Nënshkrimi i ZKA)

Faqe - 2 - nga 42

(Nënshkrimi i ZKF)

Neni 13

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme për (**KOMUNA E DRAGASHIT**)

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022

Shënim	2022	2021	2020	
	Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit	
	BKK '000	BKK '000	BKK '000	
BURIMET E FONDEVE -PRANIMET				
Granti qeveritar	8,005	6,978	8,196	
Të hyrat vetanake	755	415	814	
Të hyrat e dedikuara				
Grantet e përcaktuara të donatorëve	193	7	7	
Financimet nga huamarrja	71	70	109	
Klauzola e investimeve				
Fondi zhvillimor në mirëbesim				
Pranimet tjera				
Gjithsej	9,024	7,471	9,127	
SHFRYTEZIMI I FONDEVE - PAGESAT				
Operacionet				
Paga dhe rroga	2	4,466	4,577	4,709
Mallra dhe shërbime	3	1,076	917	1,049
Shpenzime komunale	4	125	118	115
		5,666	5,612	5,874
Transferet				
Transfere dhe subvencione	5	388	160	599
Shpenzime kapitale				
Prona, ndërtesa dhe pajisje	6	2,970	1,699	2,654
Pagesa tjera	7			
Gjithsej	9,024	7,471	9,127	

Shënim: Pagesat nga palët e treta prezantohen në shënimin 13 në përputhje me SNKPS 2017, efektive nga 1 janari 2019

Sipas nenit 13 pika 3 e Rregullores së MF për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore 01/2019, burimet e fondeve paraqesin shumën aktuale të shpenzimeve të bëra gjatë periudhës raportuese. Organizata buxhetore Komuna e Dragashit sipas të dhënave të paraqitura në pasqyrën e pranimeve dhe pagesave ka pranuar 9,024 mijë euro. Kjo shumë e pranuar është shpenzuar në shumën e njëjtë të pranimeve.

Te burimet e fondeve - huamarrjet është parqitur shuma prej 71 mijë euro. Komuna nuk ka marrë huamarrje, por që këtë huamarrje e ka marrë Ministria e Shëndetësisë.

Neni 14

Raporti i ekzekutimit te buxhetit

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për (KOMUNA E DRAGASHIT)

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022

	Shënime	2022				2021	2020	
		Realizimi	Buxheti final	Buxheti fillestar	Ndryshimi	Realizimi	Realizimi	
		A € '000	B € '000	C € '000	D=B-A € '000	E € '000	F € '000	
HYRJA E PARASË SË GATSHME								
	Të hyrat tatimore	8	296	327	327	31	268	138
	Të hyrat jo tatimore	9	239	155	155	(84)	161	115
	Të hyrat e dedikuara	10				-		
	Grantet e përcaktuara të donatorëve	11	205	205		-		8
	Tjera	12						
	Gjithsej Pranimet		740	687	482	(53)	429	261
DALJA E PARASË SË GATSHME								
	Paga dhe shtesa	2	4,466	4,909	4,831	443	4,577	4,709
	Mallra dhe shërbime	3	1,076	1,124	1,063	48	917	1,049
	Shpenzime komunale	4	125	130	130	5	118	115
	Transfere dhe subvencione	5	388	390	270	2	160	599
	Shpenzime kapitale	6	2,970	3,468	2,716	498	1,699	2,654
	Rezerva				320			
	Tjerat	7				-		
	Gjithsej pagesat		9,024	10,020	9,329	996	7,471	9,127

Pasqyra financiare mbi ekzekutimin e buxhetit është një nga pasqyrat më të rëndësishme, ngase në këtë pasqyrë paraqitet buxheti fillestar, buxheti final dhe realizimi duke u krahasuar me periudhat e njëjta paraprake të vitit raportues.

Buxheti fillestar i komunës përfshin shumën e buxhetit prej 9,329 mijë euro të miratuar në asamblenë komunale, i financuar nga dy burime dhe atë nga granti qeveritar –Fondi i Përgjithshëm, të hyrat vetanake të buxhetuara

Buxheti final i komunës është buxheti sipas gjendjes më 31.12.2022. Ky buxhet përfshin buxhetin fillestar, të hyrat vetanake, të hyrat vetanake të pashpenzuara nga viti paraprak dhe grantet e donatorëve. Shuma totale e buxhetit final arrin në 10,020 mijë euro. Kjo shumë në krahasim me buxhetin fillestar është më e lartë për 7.4%. Buxheti i periudhës raportuese është shpenzuar në shumën prej 9,024 mijë euro. Kjo shumë në raport me buxhetin final arrin shkallën e realizimit prej 90%

Neni 15

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

Shënimi 1

1. Politikat kontabël

Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”, i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

1.1 Informata për organizatën buxhetore (aktivitetet, legjislacioni, etj)

Entitet i sektorit publik Komuna e Dragashit ka përgatitur Pasqyrat Financiare në harmoni me kërkesat e Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

Sipas LMFPP të gjitha transaksionet me fonde brenda Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës bëhen përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit.

Komuna e Dragashit është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, e përbërë nga një komunitet i qytetarëve në një territor të caktuar, të përcaktuar me ligj, e cila ushtron tërë pushtetin, i cili nuk është i rezervuar shprehimisht për institucionet qendrore.

Të gjitha organet e komunës kujdesen që qytetarët e komunës t’i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë pa dallim race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik apo mendimi tjetër, prejardhjeje kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi tjetër me qëllim që ata të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në shërbimet komunale të të gjitha niveleve.

Komuna i zbaton politikat dhe praktikat e veta për të mbështetur bashkëjetesën dhe paqen ndërmjet qytetarëve të tyre dhe për të krijuar kushte të përshtatshme që u mundësojnë të gjithë komuniteteve për t’i shprehur, ruajtur, zhvilluar identitetet e tyre etnike, kulturore, fetare dhe gjuhësor.

Pasqyrat financiare janë për Komunën e Dragashit , kontrollohet nga Qeveria e Kosovës dhe të gjitha aktivitetet e tija financohen nga Buxheti i Kosovës

1.1 Pagesat nga palët e treta

Pagesat nga palët e treta prezantohen në shënimin 13

1.3 Shumat raportuese

Shumat raportuese nga neni:

13 deri te neni 15 janë në `000 (mijë) Euro (€),

16 deri te neni 24 shumat janë shuma e plotë Euro (€).

1.4 Valuta raportuese

Shumat janë raportuar në valutën Euro (€),

1.5 Data e autorizimit

Autorizohen me datën e nënshkrimit të deklaratës për Pasqyrat Financiare nga Zyrtari Kryesore Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Neni 14.6

Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit

Ndryshimet e autorizuara nga LMFP

Kategoria e ndarjes	Buxheti Fillestar	Ndryshimi	Ndryshimi	Ndryshimi	Ndryshimi	Të hyrat	Grantet e percaktuara	Burime tjera te	Buxheti	Ndryshimet e
	(Ligji i Buxhetit)	I	II	III	IV	vetanake	te donatoreve	financimit	përfundimtar	buxhetit
	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
Hyrjet										
Të hyrat tatimore	327								327	0
Të hyrat jo tatimore	155								155	0
Të hyrat e dedikuara									-	
Grantet e percaktuara të donatorëve							205		205	
Huamarrjet									-	
Tjera									-	
Gjithsej	482	-	-	-	-	-	205	-	687	0
Daljet										
Paga dhe Shtesa	4,831		6					1	4,909	2%
Mallra dhe shërbime	1,063					50		10	1,124	6%
Shpenzime komunale	130								130	0%
Transfere dhe subvencione	270					120			390	44%
Shpenzime kapitale	2,716		320			227	205		3,468	28%
Rezerva	320		(320)							
Kthimi i huamarrjeve									-	
Tjerat										
Gjithsej	9,329	0	6	0		398	216	71	10,020	7.4%

Në përfundim të vitit fiskal 2022, sipas ligjit të buxhetit siç shihet në këtë tabelë. Ministria e Shëndësisë së bashku me Ministrinë e Financave në kategorinë ekonomike paga dhe meditje me vendim të qeverisë janë paguar nga fondi i përgjithshëm 6 mijë euro dhe nga fondi i huamarjes 71 mijë euro për shtesat për pagat e punëtorëve të shëndësisë nga fondi i huamarjes.

Shuma prej 205 mijë euro nga të hyrat e donatorëve. Ambasada e Sllovakisë i ka dhënë komunës donacion për ndërtimin e parkut të qytetit dhe nga Helvetasi për Grandin e Përfomancës.

Shuma e buxhetit final prej 10,020 mijë euro është në harmoni me të dhënat e gjeneruara nga SIMFK –fribalanci. Si shihet në tabelën e buxhetit fillestar sipas ligjit të buxhetit shuma ka qënë 9,329 mijë euro, ndërsa buxheti përfundimtar final sipas SIMFK është 10,020 mijë euro ku qeveria ka bërë rritje buxhetor 7.4% të shumës buxhetore.

Shënimi 2 deri 12 Prezantim i ndryshimeve materiale

Për dallim prej shënimeve 2 deri 12, këto shënime përdoren për të sqaruar dallimin **material** në kolonën D(*neni 14*), domethënë dallimin material të realizimit të buxhetit. SNKSP në bazë të parasë së gatshme kërkon të sqarohen dallimet materiale. Varësisht nga madhësia e dallimit, nuk kanë nevojë të ofrohen shpjegime për të gjitha kategoritë, andaj mund të kërkoen ndryshime në sistemin e numërimit të shënimeve. Kur të sqarohen dallimet e ndonjë kategorie të ndarjes, duhet të jepet përmbledhja e natyrës së ndryshimit.

Shënimi nr.2

Pagat dhe shtesat sipas buxhetit fillestar janë buxhetuar në shumën prej 4,831 mijë euro. Kështu kjo kategori buxhetore sipas buxhetit final për paga arrin shumën prej 4.909 mijë euro. Nga fondi i pagave nuk janë shpenzuar 1 mijë euro të cilat i përkasin fondit të donatorëve, ku janë realizuar 91% të shumës së buxhetuar për këtë kategori buxhetore. Në raport me shpenzimet e periudhës së njëjtë raportuese nga viti paraprak ,shpenzimet paga dhe rroga janë me të ulta për 2.4%.

Shenimi nr.3

Mallrat dhe shërbimet sipas buxhetit final arrijnë shumën prej 1,124 mijë euro. Nga kjo shumë nga Fondi i Përgjithëshëm janë shpenzuar mjete në lartësi prej 1,016 mijë euro, nga fondi 22 i të hyrave vetanake në shumë 59 mijë euro. Shpenzimet totale në shumën prej 1,076 mijë euro. ose në përqindje 96 % të buxhetit total për mallra dhe shërbime. Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë në nivel më të lartë në krahasim me shpenzimet e periudhës së njëjtë raportuese të vitit paraprak.

Shuma e buxhetuar sipas buxhetit final.....	1,124 mijë euro
Shuma e shpenzuar sipa të gjitha burimeve	1,076 mijë euro
Shuma e mjeteve të pashpenzuara për mallra e shërbime	48 mijë euro.

Shenimi 4

Shpenzimet për shërbime komunale sipas buxhetit fillestar kapin shumën 130 mijë euro, ndërsa janë shpenzuar 125 mijë euro, në krahasim me buxhetin janë realizuar në shkallë prej 96%. Nga kjo kategori buxhetore nuk janë shpenzuar mjete prej 5 mijë euro të cilat i përkasin Fondit të përgjithshëm.

Shenimi nr.5

Subvencionet dhe transferet sipas buxhetit fillestar kapin shumën prej 390 mijë euro. Nga fondi 21 subvencionet dhe transferet kapin shumën prej 270 mijë euro, Të hyrat vetanake të pashpenzuara nga viti paraprak për subvencione dhe transfere janë lejuar 120 mijë euro . Shuma e shpenzuar e subvencioneve arrin shumën 388 mijë euro. Në krahasim me buxhetin final subvencionet dhe transferet janë realizuar prej 100%.

Shenimi nr.6

Buxheti final për investime kapitale është buxhetuar në shumën prej 3,468 mijë euro. Shuma e mjeteve të realizuara për investime kapitale nga të gjitha burimet arrin në 2,970 mijë euro, ndërsa nuk janë realizuar mjete në shumën prej 498 mijë euro. Në krahasim me buxhetin final për investime kapitale janë realizuar prej 86% e shumës së buxhetuar. Në raportin e vitit paraprak investimet kapitale janë me të ulta për 57 % .

Shenimi nr.7

Komuna në vitin buxhetor 2021 nuk ka marrë huamarrje, por në SIMFK fribalancë në fondin burimor 04 është buxhetuar shuma prej 71 mijë euro si financime nga huamarrjet. Ndërsa komuna ka pranuar huamarrje nga kategoria ekonomike paga dhe meditje shuma prej 71 mijë euro, ku janë paguar shtesë në paga dhe meditje për stafin e shëndetësisë

Shënimi 2 Paga dhe Rroga

Përshkrimi	2022									Ndryshimi Buxheti - Pagesat € '000	2021 € '000	2020 € '000
	Gjithsej	Buxheti										
	Pagesat € '000	FH € '000	KI € '000	FZHM € '000	GQ € '000	THV € '000	THD € '000	GPD € '000	Final € '000			
Pagat neto përmes listës së pagave	3,715	58			3,657						3,865	4,003
Pagesa per sindikatë	11				11						14	15
Pagesa neto për punë jashtë orarit	-										-	-
Puntëtorët me kontratë (jo në listen e pagave)	-										-	-
Anetaresim -Oda e infermiere të Kosoves	2				2						2	2
Anetaresim -Oda e mjekve të Kosoves	1				1						1	1
Tatimi ndaluar në të ardhura personale	216	6			210						229	241
Kontributi pensional-punetori	206	3			203						215	224
Kontributi pensional-punëdhënësi	206	3			203						215	224
Pagesat për vendime gjyqësore	109				109						37	
Paga dhe rroga	4,466	71	-	-	4,395	-	-	-	4,909	443	4,577	4,709

Shpalos në detaje shënimet e pasqyruara në tabelë:

Pagat dhe medijtjet në vitin buxhetor 2022 janë paguar në shumën prej 4,466 mijë euro. Sipas buxhetit final kjo kategori buxhetore ka qenë e buxhetuar në shumën prej 4.909 mijë euro, ku janë realizuar 91% të shumës së buxhetuar për këtë kategori buxhetore. Në raport me shpenzimet e periudhës së njëjtë raportuese nga viti paraprak, shpenzimet paga dhe medijtje janë me të ulta për 2.4%.

Shënimi 3 Mallra dhe Shërbim

Përshkrimi	2022								Buxheti Final € '000	Ndryshimi Buxheti - Pagesat € '000	2021 € '000	2020 € '000
	Gjithsej Pagesat € '000	FH € '000	KI € '000	FZHM € '000	GQ € '000	THV € '000	THD € '000	GPD € '000				
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit	27				27					20	6	
Shpenzime tjera për udhëtime zyrtare brenda vendit	-										13	
Akomodimi udhëtime zyrtare brenda vendit	-											
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	15				15							
Meditjet për udhëtime zyrtare jashtë vendit	-											
Shpenzime të vogla para gjepi	5				5						3	
Shpenzime tjera udhëtime zyrtare jashtë vendit	-											
Shpenzimet për internet	2				2					4	2	
Shpenzimet e telefonisë mobile	22				22					21	24	
Shpenzimet postare	3				3					2	1	
Shpenzimet për përdorimin e kabllit optik	0				0					0	0	
Shërbimet e arsimit trajnimit	-											
Sherbime shtypje-jo marketing	2				2					3	2	
Sherbime kontraktuese tjera	80				50	30				89	94	
Sherbime teknike	4				4	0				2	6	
Shpenzimet për anetaresim	11				11					10	3	
Sherbimet e varrimit	59				59					62	49	
Mobilje (me pak se 1000 euro)	40				40					54	22	
Telefona (me pak se 1000 euro)	-											
Kompjuterë (me pak se 1000 euro)	25				25					11		
Makina fotokopjuese	-											
Paisje speciale mjeksore me pak se 1000 euro	0				0					8	21	
Paisje tjera me pak se 1000 euro	49				49					78	25	
Furnizime për zyrë	38				38					48	41	
Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	3				3	0				6	62	
Furnizime mjeksore	68				61	7				69	244	
Furnizime pastrimi	5				5					17	31	
Furnizime me veshmbathje	-									1	2	
Vaj	-									0		
Furnizim me perparate kimike	-										0	
Blloibat	-										0	
Nafte për ngrohje qendrore	127				127					142	61	
Qymyr	-											
Dru	202				189	13				109	84	
Derivate për gjenerator	5				5					2	3	
Karburante për vetura	80				73	7				49	35	
Gaz natyror	-									0	0	
Regjistrimi i automjeteve	3				3					3	2	
Sigurimi i automjeteve	10				10					7	7	
Taksa komunale e regjistrimit të automjeteve	0				0					0	0	
Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve	32				29	3				31	22	
Mirembajtja e ndërtesave	22				22					1	17	
Mirembajtja e auto rrugeve lokale	2				2					8	79	
Mirembajtja e shkollave	23				23					11	34	
Mirbajtja e objekti shëndetsor	-										1	
Mirembajtja e teknologjise informative	1				1					4	4	
Mirembajtja e mobiljeve dhe paisjeve	5				5					4	16	
Mirembajtja rutinore	67				67	0				7	9	
Reklamat dhe konkurset	1				1					1	1	
Botimet e publikimeve	-									0	0	
Shpenzimet e inf.publik	9				9					5	7	
Dreka zyrtare	12				12	0				8	10	
Shpenzimet e ekzekutimit të vendimeve gjqesore	13				13					20	8	
Mallra dhe Sherbime	1,076	-	-	-	1,016	59	-	-	1,124	48	917	1049

Shpenzimet për mallra e shërbime në vitin raportues janë realizuar në shumën prej 1,076 mijë euro. Këto shpenzime janë financuar nga Fondi i përgjithshëm në shumën prej 1,016 mijë euro, nga burimet e mjeteve vetanake nga fondi 22 janë realizuar shpenzime në shumën prej 59 mijë euro. Shpenzimet totale në shumën prej 1,076 mijë euro paraqesin 96 % të buxhetit total për mallra e shërbime. Nga paraqitja tabelare e shpenzimeve shihet se shpenzimet totale për mallra dhe shërbime janë në nivelin me të lartë, në krahasim me shpenzimet e periudhës së njëjtë raportuese nga viti paraprak.

Shënimi 4 Shpenzime Komunale

Përshkrimi	Gjithsej								Buxheti	Ndryshimi Buxheti - Pagesat	2021	2020
	Pagesat € '000	FH € '000	KI € '000	FZHM € '000	GQ € '000	THV € '000	THD € '000	GPD € '000	Final € '000	€ '000	€ '000	€ '000
Rryma	57				57						53	49
Uji	15				15						16	15
Mbeturinat	50				50						46	48
Ngrohja Qendrore												
Shpenzimet telefonike	4				4						3	3
Pagesa-vendimet gjyqësore												0
Shpenzime komunale	125				125				130	5	118	115

Shpalos në detaje shënimet në tabelë:

Shpenzimet komunale si kategori buxhetore në vitin 2022, sipas buxhetit fillestar janë buxhetur në shumën prej 130 mijë euro, që financohen nga Fondi i përgjithshëm. Shpenzimet komunale të realizuara në vitin raportues janë 125 mijë euro, që paraqesin 96% të shumës së buxhetuar për këtë kategori buxhetore.

Në raport me shpenzimet e periudhës së njëjtë raportuese nga viti paraprak, shpenzimet komunale janë me të larta për 5%.

Shënimi 5 Subvencione dhe Transfere

Përshkrimi	2022										2021 € '000	2020 € '000	
	Gjithsej									Buxheti			Ndryshimi Buxheti - Pagesat
	Pagesat € '000	FH € '000	KI € '000	FZHM € '000	GQ € '000	THV € '000	THD € '000	GPD € '000	Final € '000	€ '000			
Subvencione për entitetet publike	-												
Subvencionet për entitetet publike (tea.bib)	-												
Subvencione për entitetet jopublike	165					165				294	56	57	
Transfere për qeveri tjera	-												
Pagesat për përfituesit individual	179					179				172	104	543	
Pensionet bazë	-												
Pensionet baze kotributdhënëse	-												
Pensionet për personat me nevoja të veçanta	-												
Pensionet e ndihmës sociale	-												
Pensionet për te burgosurit	-												
Pensionet për veteranët e luftës	-												
Pensionet për te verbërit	-												
Pensionet e TMK-së	-												
Pensionet e FSK-së	-												
Pagesat për invalidët e luftës	-												
Pagesat për familjet e të rënëve në luftë	-												
Pensionet e përkohshme të Trepçës	-												
Pushimi i lehonave	-												
Pagesa për vendime gjyqesore	44					44							
Pagesat për sektorin e blegtorisë	-												
Pagesat për kulturat	-												
Ristrukturimi i potencialit fizik	-												
Menaxhimi i burimeve të ujitjes për bujqësi	-												
Diversifikimi i fermave	-												
Subvencione dhe transfere	388	-	-	-	-	388	-	-	390	2	160	599	

Subvencionet e transferet si kategori buxhetore janë financuar nga fondi i përgjithshëm si dhe nga burimet e mjeteve vetanake. Kjo kategori buxhetore është shpenzuar në shumën prej 388 mijë euro. Shuma e buxhetuar për kategorinë e subvencioneve dhe transfereve sipas buxhetit final arrin në 390 mijë euro, 270 mijë janë nga fondi 21 dhe 120 mijë nga të hyrat vetanake të bartura nga vitit paraprak fondi 22

Shënimi 6 Shpenzime Kapitale

Përshkrimi	2022								Buxheti Final € '000	Ndryshimi Buxheti - Pagesat € '000	2021 € '000	2020 € '000
	Gjithsej Pagesat € '000	FH € '000	KI € '000	FZHM € '000	GQ € '000	THV € '000	THD € '000	GPD € '000				
Objektet arsimore	289				204	85				300	67.97	237
Objektet shëndetësore	182				168	14						74
Objektet kulturore	55				28	27				77	36.14	68
Objektet sportive	-											16
Rrethoja	10				10					27	37.48	29
Fusha Sporti	71				20	1		50			67.67	83
Ndërtimi i rrugëve lokale	1,679				#####	39		128		178	943.49	1,539
Trotuaret	-										.	44
Kanalizimi	57				50	7				136	41.78	49
Ujësullësi	223				167	55				163	136.20	226
Mirmbajtja investive	145				110	20		15			189.53	138
Furnizimi me rrymë gjenerator trafns	125				95	30						
Pajisje të teknologjis inform	-									0	10.18	3
Pajisje tjera	16					16						19
Pajisje speciale mjeksore	-											
Vetura e ndimës së shpejtë	80				80						104.79	
Vetura zyrtare	30				25	5						4
Mkineria	-											75
Transfer i kapitaleve per ent.publike	-											
Transfer i kapitaleve për ent. jo publike	-											40
Rregullimi i Lumenjve	-										34.33	
Pagesa e vendimeve gjyqesore	8					8					29.00	
Toka	-											9
Shpenzimet Kapitale	2,970	-	-	-	2,470	307	-	193	3,468	498	1,699	2,654

Shpenzimet për investime kapitale sipas të gjitha burimeve janë buxhetuar në shumën prej 3,468 mijë euro, nga kjo :

Nga fondi i përgjithshëm 2,134 mijë euro.

Nga burimet e mjeteve vetanake fondi 21 dhe 22 , 437 mijë euro.

Nga burimet e mjeteve nga donatorët, Ambasada Slovakisë dhe Helvetasi 205 mijë euro.

Shuma e buxhetuar prej 3,468 mijë euro është realizuar në shumën 2,970 mijë ose 86% e shumës së buxhetuar.

Shpenzimet për investime kapitale të periudhës raportuese në raport me periudhën e njëjtë raportuese të vitit paraprak janë realizuar per 57% më shumë.

Shënimi 7 Tjera

Natyra e pagesës	2022	2021	2020
	€ '000	€ '000	€ '000
Depozita 1			
Depozita 2			
Depozita 3			
Depozitat tjera			
Gjithsej	0	0	0

Shpalos në detaje shënimet në tabelë:

Shënimi 8 Te hyrat tatimore

Përshkrimi	Shënim e	2022	2021	2020	% e totalit 2022	% e ndryshimit nga 2021
		€ '000	€ '000	€ '000		
Tatimi në pronë		296	268	138	100%	111%
					%	%
					%	%
					%	%
Gjithsej		296	268	138	100%	%

Shpalos në detaje shënimet në tabelë:

Të hyrat tatimore, tatimi në pronë për vitin 2022 janë inkasuar në shumën prej 296 mijë euro. Kjo shumë është më e lartë se në periudhën e njëjtë raportuese të vitit paraprak për 11%. Në raport me planin, të hyrat nga tatimi në pronë janë realizuar në shkallë prej 111%. Ne shumën e tatimit janë të përfshira edhe obligimet e tatimpaguesve nga vitet paraprake, kamatat dhe ndëshkimet

Të hyrat tatimore kanë tejkaluar planin e inkasimit

Shënimi 9 Të hyrat jo tatimore

Përshkrimi	Shënim e	2022	2021	2020	% e totalit 2022	% e ndryshimit nga 2021
		€ '000	€ '000	€ '000		
Të hyrat nga taksat 1		132	140	93	56%	87%
Të hyrat nga taksat 2					%	%
Të hyrat nga dënimet-gjobat 1					%	%
Të hyrat nga dënimet-gjobat 2					%	%
Të hyrat nga licencat 1		22	9	2	9%	5%
Të hyrat nga licencat 2					%	%
Të hyrat nga shitja e pasurisë dhe shërbimeve		80	12	19	34%	7%
Të hyrat nga inspektimi		2	1	1	1%	0%
Të hyrat nga interesi bankar					%	%
Të hyrat nga ndryshimet e pozicionit të kursit					%	%
Tarifa për akreditim					%	%
Të hyrat nga pasuria					%	%
Pranimet tjera					%	%
Gjithsej		235	161	115	100%	100%

Shpalos në detaje shënimet në tabelë:

Të hyrat jo tatimore janë të hyra të cilat inkasohen nga taksat komunale, taksat për certifikata, licencat, qiratë për shfrytëzimin e pronës komunale dhe participimi për shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore në mjekësi.

Të hyrat jo tatimore në periudhën raportuese janë inkasuar në shumën prej 235 mijë euro. Këto të hyra në raport me të hyrat e periudhës së njëjtë raportuese të vitit paraprak janë me të larta për 69%.

Te kjo pasqyrë nuk janë të paraqitura të hyrat nga gjobat e trafikut, e gjykatave si dhe nga të hyrat e agjencionit të pylltarisë për shkak se ata vet i paraqesin në pasqyrat e veta, prandaj në si komunë nuk i paraqesin, vetëm mundemi t'i përshkruajmë se sa të hyra kemi pasur. Kemi pasur të hyra jo tatimore, por që i përkasin fondit 10 kompenzimi i dëmeve nga kompania e sigurimeve dhe kthimi i dy pagave, gjithsej 5 mijë euro

Gjobat e trafikut 68,360.25euro

Gjobat e gjykatave 1,621.32 euro

Agjencionit i pyjeve 10,067.19 euro

Shënimi 10 Të hyrat e dedikuara

Përshkrimi	Shënime	2022	2021	2020	% e totalit 2022	% e ndryshimit nga 2021
		€ '000	€ '000	€ '000		
Lloji i të hyrës 1						
Lloji i të hyrës 2					%	%
Lloji i të hyrës 3					%	%
Lloji i të hyrës 4					%	%
Gjithsej		0	0	0	0%	%

Shpalos në detaje shënimet e pasqyruara në tabelë:

Shënimi 11 Grantet e përcaktuara të donatorëve

Përshkrimi		2022	2021	2020
		€ '000	€ '000	€ '000
AMBASADA E BULLGARIES	93234 Permirsimi i shërbimit emergjent			8
AMBASADA E SLOVAKIS	92142 Ndertimi i mjë parku ne qytet	7	-	-
HELVETAS QEVERIA ZVICRANI	92136 Skema e grandit për performanc komunale	198	-	-
Gjithsej		205	0	8

Shpalos në detaje shënimet e pasqyruara në tabelë:

Shënimi 12 Tjera

<u>Natyra e pranimit</u>	<u>2022</u> <u>€ '000</u>	<u>2021</u> <u>€ '000</u>	<u>2020</u> <u>€ '000</u>
Depozitat 1			
Depozitat 2			
Depozitat 3			
Depozitat tjera			
↓			
Gjithsej	<u>0</u>	<u>0</u>	<u>0</u>

Shpalos në detaje shënimet në tabelë:

Shënimi 13 Pagesa nga palët e treta

<u>Kategoria ekonomike</u>	<u>2022</u> <u>€ '000</u>	<u>2021</u> <u>€ '000</u>	<u>2020</u> <u>€ '000</u>
Paga dhe rroga			
Mallra dhe shërbime		7	7
Shpenzime komunale			
Transfere dhe subvencione			
Shpenzime kapitale	193		
Gjithsej pagesat nga palët e treta	<u>193</u>	<u>7</u>	<u>7</u>

Shpalos tabelën në detaje si në tabelën në vijim aneks 1:

Neni 16 Raport për të arkëtueshmet
Të arkëtueshmet (zbatohet për organizatat që mbledhin të hyra)

Kodi ekonomik	Përshkrimi	2022	2021	2020
	Tatimi në pronë	844,100.45	1,175,279.14	1,152,177.64
	Taksa komunale ne biznese	596,636.11	595,806.78	595,806.78
	Shfrytëzimi i pronës komunale	222,204.42	309,500.27	281,234.66
